



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

**KOSOVA  
DEMOCRATIC  
INSTITUTE**

**TRANSPARENCY  
INTERNATIONAL  
KOSOVA**

# PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIFIKIMIT TË PROKURIMIT KOMUNAL NË KOSOVË 2019

Në komunat e Prizrenit, Suharekës, Ferizajt, Lipjanit,  
Podujevës dhe Istogut

TETOR 2019



TRANSPARENCY AND  
ANTI-CORRUPTION



# **PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIFIKIMIT TË PROKURIMIT KOMUNAL NË KOSOVË 2019**

**Në komunat e Prizrenit, Suharekës, Ferizajt, Lipjanit,  
Podujevës dhe Istogut**

**TETOR 2019**

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10 000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +383 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

**Përgatiti:** Diana Metushi Krasniqi

**Asistentë të hulumtimit:** Abedin Imami, Bekim Krasniqi, Erolina Morina and Shpend Sopa

**Layout and design:** envinion

**Vërejtje:** Ky raport është realizuar në kuadër të projektit “*Rritja e Pjesëmarrjes, Transparencës dhe Llogaridhënies në Kosovë*”, financuar nga Fondi për Demokraci i Kombeve të Bashkuara (UNDEF). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe në asnjë rrethanë nuk konsiderohet që reflekton qëndrimet e donatorit.

# PËRMBAJTJA

|                                                                                         |    |
|-----------------------------------------------------------------------------------------|----|
| LISTA E SHKURTESAVE.....                                                                | 6  |
| LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKËVE.....                                                     | 7  |
| PËRMBJEDHJE EKZEKUTIVE .....                                                            | 8  |
| I. HYRJA .....                                                                          | 10 |
| II METODOLOGJIA .....                                                                   | 12 |
| III PRAKTIKAT E MIRA.....                                                               | 13 |
| IV. PAJTUESHMËRIA LIGJORE .....                                                         | 14 |
| V. TRANSPARENCA .....                                                                   | 15 |
| VI. MJEDISI OPERATIV .....                                                              | 16 |
| 1. Planifikimi i aktiviteteve.....                                                      | 16 |
| PRIZREN: .....                                                                          | 18 |
| SUHAREKË: .....                                                                         | 19 |
| FERIZAJ: .....                                                                          | 20 |
| LIPJAN:.....                                                                            | 21 |
| PODUJEVË: .....                                                                         | 22 |
| ISTOG:.....                                                                             | 23 |
| 2. Kapacitetet Buxhetore (Planifikimi i Prokurimit kundrejt Buxhetit Komunal 2019)..... | 24 |
| 3. Vlerësimi i kapacitetit dhe aftësive planifikuese së Zyrave të Prokurimit.....       | 26 |
| VII. HULUMTIMI I TREGUT .....                                                           | 27 |
| VIII. MENAXHIMI I RREZIKUT.....                                                         | 28 |
| X. KONKLuzionET .....                                                                   | 29 |
| XI. REKOMANDIMET.....                                                                   | 31 |
| SHTOJCA 1: PASQYRAT INDIVIDUALE TË KOMUNAVE.....                                        | 32 |
| ISDY: Komuna e Prizrenit .....                                                          | 32 |
| ISDY: Komuna e Suharekës .....                                                          | 33 |
| YAHR: Komuna e Ferizajt.....                                                            | 34 |
| YAHR: Komuna e Lipjanit.....                                                            | 35 |
| Ekovizioi: Komuna e Podujevës.....                                                      | 36 |
| Syri i Vizionit: Komuna e Istogut.....                                                  | 37 |
| SHTOJCA 2: Kërkesat ligjore.....                                                        | 38 |
| SHTOJCA 3: Formulari i monitorimit të planifikimit të prokurimit.....                   | 40 |

# LISTA E SHKURTESAVE

|             |                                                    |
|-------------|----------------------------------------------------|
| <b>AK</b>   | AUTORITET KONTRAKTUES                              |
| <b>AQP</b>  | AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT                     |
| <b>ISDY</b> | INSTITUTI PËR QËNDRUESHMËRI DHE ZHVILLIM TË RINISË |
| <b>KK</b>   | KUVENDI KOMUNAL                                    |
| <b>KAB</b>  | KORNIZA AFATMESME BUXHETORE                        |
| <b>KDI</b>  | INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS                     |
| <b>KRPP</b> | KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK          |
| <b>LPP</b>  | LIGJI PËR PROKURIM PUBLIK                          |
| <b>OJQ</b>  | ORGANIZATA JO-QEVERITARE                           |
| <b>YHR</b>  | ASOCIACIONI I TË RINJËVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT  |
| <b>ZKA</b>  | ZYRTARI KRYESOR ADMINISTRATIV                      |

# LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKËVE

**Tabela 1.** Afatet e hartimit të planifikimit të prokurimit, **fq. 14**

**Tabela 2.** Datat e dorëzimit të planifikimit përfundimtar të prokurimit në AQP, **fq. 14**

**Tabela 3.** Datat e publikimit të planifikimit të prokurimit në ueb faqet e komunave, **fq. 15**

**Tabela 4.** Planifikimet sipas kategorisë së prokurimeve, **fq. 16**

**Tabela 5.** Planifikimi i prokurimeve për festa për komunat e Prizrenit, Lipjanit dhe Podujevës, **fq. 17**

**Tabela 6.** Krahاسimi ndërmjet dhjetë tenderëve të parë për furnizime të shpallura nga komuna e Prizrenit kundrejt planifikimit përfundimtar të prokurimit, **fq. 18**

**Tabela 7.** Krahاسimi ndërmjet dhjetë tenderëve të parë për furnizime të shpallura nga komuna e Suharekës kundrejt planifikimit përfundimtar të prokurimit, **fq. 19**

**Tabela 8.** Krahاسimi ndërmjet dhjetë tenderëve të parë për furnizime të shpallura nga komuna e Ferizajt kundrejt planifikimit përfundimtar të prokurimit, **fq. 20**

**Tabela 9.** Krahاسimi ndërmjet dhjetë tenderëve të parë për furnizime të shpallura nga komuna e Lipjanit kundrejt planifikimit përfundimtar të prokurimit, **fq. 21**

**Tabela 10.** Krahاسimi ndërmjet dhjetë tenderëve të parë për furnizime të shpallura nga komuna e Podujevës kundrejt planifikimit përfundimtar të prokurimit, **fq. 22**

**Tabela 11.** Krahاسimi ndërmjet dhjetë tenderëve të parë për furnizime të shpallura nga komuna e Istogut kundrejt planifikimit përfundimtar të prokurimit, **fq. 23**

**Tabela 12.** Vlera e prokurimeve të planifikuara kundrejt vlerës së buxhetit komunal për vitin 2019, **fq. 24**

**Grafiku 1.** Dallimi ndërmjet numrit të planifikimeve për investime kapitale kundrejt buxhetit për 2019, **fq. 25**

**Tabela 13.** Vlerat monetare ndërmjet buxhetit të aprovuar dhe planifikimet përfundimtare për vitin 2019, **fq. 25**

**Tabela 14.** Numri i prokurimeve të planifikuara për 2019 kundrejt numrit të zyrtarëve të prokurimit, **fq. 26**

# PËRMBJEDHJE EKZEKUTIVE

Planifikimi i prokurimit është një plan i hartuar nga komuna, i cili shpenzimet e aprovuara nga buxheti për vitin në vijim, i përkthen në kategorizim të aktiviteteve të prokurimit, përfshirë datat e parashikuara për zhvillimin e këtyre prokurimeve dhe shumat e planifikuara. Këto plane, përveç që ndihmojnë komunat për përgatitje të brendshme dhe koordinim ndërmjet akterëve të përfshirë, ndihmojnë edhe autoritetet qendrore për identifikimin e prokurimeve të përbashkëta, dhe gjithashtu ndihmojnë bizneset në planifikimin dhe parapërgatitjet për ofertat e tyre.

Ky raport trajton procesin dhe analizon planifikimet e prokurimit për komunat e Prizrenit, Suharekës, Ferizajt, Lipjanit, Podujevës dhe Istogut për vitin 2019.

Ky projekt është përqendruar në dy qëllime (1) fuqizimin e OShC-ve lokale në monitorimin e planifikimit të prokurimit, dhe (2) synon të bashkojë aspektet kryesore të performancës së komunave në procesin e planifikimit të prokurimit për vitin 2019, me fokus:

**(a)** Përmeshja e kërkesave ligjore dhe procedurave për hartimin dhe aprovimin e planifikimit të prokurimit në komunat e Prizrenit, Suharekës, Ferizaj, Lipjan, Podujeva, dhe Istog, dhe identifikimi i praktikave të mira në këto komunat; dhe

**(b)** analizimin e mjedisit operativ lidhur me hartimin e planifikimit të prokurimit për komunat e Prizrenit, Suharekës, Ferizaj, Lipjan, Podujeva, dhe Istog.

Observimet e këtij procesi tregojnë se përderisa të gjashtë komunat kishin respektuar afatet ligjore për hartimin dhe dorëzimin e planeve të prokurimit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit, vonesat në aprovimin e buxhetit për 2019 nga Kuvendi i Kosovës<sup>1</sup> kishin shkaktuar vonesa në fillimin e proceseve të prokurimit në komuna. Këto vonesa mund të kenë ndikim negativ edhe në aspektin afatgjatë të kontratave. Këto vonesa rezultojnë në shtyrjen e fillimit të procesit të tenderimit, të dhënies së kontratës, realizimit të kontratës, respektivisht mungesën e furnizimit me materiale në kohë, apo vonesa në realizimin e punëve, si dhe rrezikun e bartjes së obligimeve në vitin e ardhshëm, respektivisht nivel më të ulët të realizimit të buxhetit për vitin 2019.

1 Ligji Nr. 06/L-133 i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me datën 03 shkurt 2019, i cili ka hyrë në fuqi me datën 14 shkurt 2019.

Duke pasur parasysh rezultatet e kësaj analize krahasuese, hulumtimi nënvizon se sfidat kyçe që e kanë përcjellë procesin e hartimit të planifikimit në këto komuna dhe që kërkojnë vëmendjen e komunave janë (1) mbikëlimi i vlerave të buxhetuara; (2) alokimi jo proporcional i zyrtarëve të prokurimit, (3) detyrimet e bartura nga vitet paraprake në komunat e Prizrenit dhe Ferizajt, (4) mungesa e hulumtimit të tregut nga autoritetet kontraktuese, (5) mungesa e analizimit të rrezikut, (6) ndarja e kërkesave dhe (7) mos planifikimi i prokurimeve për shënimin e festave dhe përvjetorëve.

[illegible]

## FAZAT E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË

Sipas legjislacionit aktual në për prokurim publik në Kosovë(1), secili proces i prokurimit kalon në tetë hapa të rëndësishëm.

**HAPI 1**

Planifikimi i Prokurimit

**HAPI 5**

Publikimi

**HAPI 2**

Parashikimi i Vlerës dhe Klasifikimi i Kontratës

**HAPI 6**

Hapja dhe Vlerësimi i Tenderëve

**HAPI 3**

Përcaktimi i Procedurës së Prokurimit

**HAPI 7**

Dhënia dhe Nënshkrimi i Kontratës

**HAPI 4**

Përgaditja e Dosjes së Tenderit

**HAPI 8**

Menaxhimi i Kontratës

(1) Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik.

## II METODOLOGJIA

Për të portretizuar me sa më saktësi performancën e komunave, KDI u konsultua ngushtë me legjislacionin për rregullat e prokurimit publik si metodologjitë e përdorura nga organizata të njohura si Shkolla e Prokurimit (Procurement Classroom) dhe Instituti i Certifikuar për Prokurim dhe Furnizime (Chartered Institute for Procurement and Supply) metodologjisë së përgatitjes së planeve të prokurimit.

KDI siguroi një trajnim të hollësishëm për anëtarët e konsorciumit lidhur me planifikimin e prokurimeve, dhe trajnime të vazhdueshme, KDI gjithashtu hartoi një formular për monitorimin e këtij procesi për të adresuar praktikën dhe kërkesat ligjore në hartimin e këtij dokumenti. Kjo formë përfshin përgjigje në pyetje siç janë përmbushja e afateve ligjore, krahasimi i planifikimit me buxhetin dhe kornizën afatmesme buxhetore, shqyrtimi i kërkesave të natyrës së njëjtë, planifikimi i prokurimeve për festa dhe përvjetorë dhe sfidave gjatë hartimit të planifikimit të prokurimit. OSHC-të lokale gjithashtu u këshilluan me udhëheqjen komunale dhe zyrën e prokurimit në lidhje me procedurat dhe veprimet për planifikimin e prokurimit. Gjithashtu, këto organizata ishin edhe përfutuese të trajnimeve të organizuara nga USAID TEAM në komunat e Prizrenit, Suharekës, Lipjanit dhe Podujevës.

Për më tepër, për të analizuar korrektësinë e planifikimeve kundrejt nevojave të komunave, KDI ka analizuar 10 tenderët e parë për furnizime, të shpallura nga komunat e Prizrenit, Suharekës, Ferizajt, Lipjanit, Podujevës dhe Istogut.

Rezultatet e këtij raporti bazohen në performancën e komunave në pajtueshmëri me kërkesat ligjore, dhe nevojave reale të komunave.

Si përmbledhje, ky hulumtim u bazua në mbledhjen e të dhënave si më poshtë:

- Analizën e planeve të prokurimit për 2019 për gjashtë komunat;
- Analiza e gjashtë buxheteve të aprovuara për 2019;
- Analiza e gjashtë buxheteve të vitit 2018;
- Analiza e gjashtë kornizave afatmesme buxhetore për 2019-2021;
- Analizë e pajtueshmërisë së komunave me kërkesat ligjore nga ligji për prokurim publik;
- Analiza e 60 tenderëve të parë për furnizime të shpallura në 2019 (10 tenderët e parë për secilën komunë pjesë të analizës)
- Intervista dhe konsultime me udhëheqjen komunale siç janë kryetarët e komunave, drejtorët e departamentit të financave dhe udhëheqësit e zyrës apo departamentit të prokurimit;
- Monitorimi i 17 takimeve për hartimin e planifikimit të prokurimit në gjashtë komuna.

## III. PRAKTIKAT E MIRA

Ky hulumtim nxjerr në pah disa praktika të mira nga komuna të ndryshme.



Zyra e Prokurimit në Komunën e Suharekës kishte filluar të punoj në planifikimin e prokurimit menjëherë pas aprovimit të planit të buxhetit nga kryetari i komunës. Kjo ishte bërë me qëllim që të kishte sa më shumë kohë për konsultim me departamentet përkatëse rreth afateve dhe çmimeve.



Komuna e Ferizajt kishte harmonizuar planifikimet e prokurimit për vitin 2019 duke planifikuar vetëm 16% të buxhetit për investime, me qëllim të zbutjes së detyrimeve të trashëguara nga vitet paraprake e që përbëjnë 18% të buxhetit për këtë kategori.



Komuna e Istogut paraqet një shembull të mirë, ku planifikimi i prokurimit i publikuar në ueb faqen e komunës është në formatin Excel, i lehtë për tu shkarkuar dhe orientuar nga përdoruesit. Ky format na mundëson që shumë lehtë të bëjmë krahasimet dhe kalkulimet jo vetëm në këtë dokument, por edhe kundrejt të dhënave të tjera të krahasueshme.



Komunat e Prizrenit, Suharekës, Lipjanit dhe Podujevës, kishin paraparë në planifikimin e prokurimit aktivitete për shënimin e përvjetorëve gjatë vitit 2019, për të evituar prokurime pa plan.

## IV. PAJTUESHMËRIA LIGJORE

Hulumtimi në fjalë tregon se të gjashtë komunat e monitoruara kishin përmbushur obligimet ligjore për sa i përket draftimit të planifikimit të prokurimit.

Këto procedura ishin filluar menjëherë pas aprovimit të propozim buxhetit për vitin 2019 nga kuvendet komunale

(shtator 2018), dhe ishin dorëzuar tek kryetarët e komunave jo më vonë se 1 dhjetor 2018.

Tabela në vijim pasqyron datat e fillimit të procedurave dhe dorëzimit tek kryetarët e komunave për secilën nga komunat e monitoruara:

|                                         | Prizren     | Suharekë    | Ferizaj     | Lipjan      | Podujevë    | Istog       |
|-----------------------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Data e fillimit të procesit             | 01.10.2018  | 01.09.2018. | 01.10.2018. | 01.10.2018. | 01.10.2018. | 30.10.2018. |
| Data e dorëzimit tek kryetari i komunës | 30.11.2018. | 01.12.2018. | 01.12.2018. | 01.12.2018. | 01.12.2018. | 30.11.2018. |

**TABELA 1. AFATET E HARTIMIT TË PLANIFIKIMIT TË PROKURIMIT**

Gjithashtu, komunat kishin përmbushur edhe afatin prej 15 ditësh, pas shpalljes së miratimit të buxhetit për vitin fiskal<sup>3</sup>, për dorëzimin e planifikimit final të prokurimit në AQP.

Tabela në vijim pasqyron afatet e dorëzimit në AQP për secilën nga komunat e monitoruara:

|                         | Prizren     | Suharekë    | Ferizaj     | Lipjan      | Podujevë    | Istog       |
|-------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Data e dorëzimit në AQP | 07.02.2019. | 21.02.2019. | 15.02.2019. | 15.01.2019. | 28.02.2019. | 05.02.2019. |

**TABELA 2. DATAT E DORËZIMIT TË PLANIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR TË PROKURIMIT NË AQP**

Komunat e Prizrenit, Lipjanit dhe Istogut kishin dorëzuar në AQP planifikimin e prokurimit para aprovimit të buxhetit nga Kuvendi i Kosovës. Megjithatë, komunat duhet të presin deri në miratimin e ligjit për buxhetin para se të dorëzojnë planifikimet e tyre në AQP.

rrezikuar. Megjithatë, komunat duhet të presin deri në miratimin e ligjit për buxhetin para se të dorëzojnë planifikimet e tyre në AQP.

3 Ligji Nr. 06/L -133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, 14 shkurt 2019

# TRANSPARENCA

Të gjitha komunat kishin ofruar bashkëpunim të plotë gjatë këtij hulumtimi si dhe kishin ofruar qasje përveç në dokumente, edhe në takimet për zhvillimin e këtij planifikimi.

Për më tutje, të gjashtë komunat e monitoruara kishin publikuar planifikimet e prokurimit në ueb faqet e tyre. Tabela në vijim pasqyron datat e publikimit për secilën nga komunat e monitoruara:

|                                          | Prizren     | Suharekë    | Ferizaj     | Lipjan      | Podujevë    | Istog       |
|------------------------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Data e publikimit në ueb faqe të komunës | 28.02.2019. | 21.02.2019. | 22.02.2019. | 01.03.2019. | 26.03.2019. | 14.02.2019. |

**TABELA 3. DATAT E PUBLIKIMIT TË PLANIFIKIMIT TË PROKURIMIT NË UEB FAQET E KOMUNAVE**

Komuna e Istogut paraqet një shembull të mirë, ku planifikimi i prokurimit është në formatin MS Excel, i lehtë për tu shkarkuar dhe orientuar nga përdoruesit. Komuna e Prizrenit e kishte publikuar planifikimin në formatin MS Word,

ndërsa të tjerat në formatin Adobe PDF, të gjitha këto më të vështira për t'u përdorur apo ri-përpunuar të dhënat.

# VI. MJEDISI OPERATIV

Analiza e mjedisit operativ gjatë hartimit të planifikimit të prokurimeve vlerëson aftësinë dhe kapacitetet e autoriteteve kontraktuese, ndikimet e jashtme dhe palët kryesore të interesit, në mënyrë që planifikimi të jetë sa

më i drejtë. Analiza në vijim pasqyron të gjeturat e mjedisit operativ në departamentet e prokurimit publik në komunat e Prizrenit, Suharekës, Ferizajt, Lipjanit, Podujevës dhe Istogut.

## 1. Planifikimi i aktiviteteve

Gjashtë komunat e monitoruara kishin planifikuar gjithsej 637 aktivitete të prokurimit së bashku. Komuna me më së shumti aktivitete të prokurimit të planifikuara ishte ajo

e Prizrenit, ndërsa komuna me numrin më të vogël ishte ajo e Lipjanit. Tabela në vijim pasqyron planifikimet sipas kategorisë së prokurimeve.

| Qyteti /               | Prizren    |                   | Suharekë   |                  | Ferizaj   |                  | Lipjan    |                  | Podujevë   |                  | Istog      |                  |
|------------------------|------------|-------------------|------------|------------------|-----------|------------------|-----------|------------------|------------|------------------|------------|------------------|
| Kategoria              | #          | Vlera €           | #          | Vlera €          | #         | Vlera €          | #         | Vlera €          | #          | Vlera €          | #          | Vlera €          |
| Furnizim               | 32         | 2,009,171         | 18         | 816,600          | 27        | 1,202,678.96     | 27        | 565,899          | 30         | 774,100          | 23         | 793,230          |
| Shërbime               | 24         | 1,854,026         | 21         | 896,805          | 15        | 524,757.28       | 21        | 494,770          | 32         | 497,600          | 15         | 320,500          |
| Punë                   | 94         | 9,616,771         | 65         | 3,547,910        | 38        | 3,312,643.98     | 28        | 2,449,155        | 60         | 4,839,607        | 63         | 2,100,500        |
| Kontratë për projektim | 3          | 120,000           | 0          | 0                | 1         | 50,000.00        | 0         | 0                | 0          | 0                | 0          | 0                |
| Gjithsej               | <b>153</b> | <b>13,599,968</b> | <b>104</b> | <b>5,261,315</b> | <b>81</b> | <b>5,090,080</b> | <b>76</b> | <b>3,509,824</b> | <b>122</b> | <b>6,111,307</b> | <b>101</b> | <b>3,214,230</b> |


**TABELA 4.** PLANIFIKIMET SIPAS KATEGORISË SË PROKURIMEVE

Siç mund të shohim nga tabela e më sipërme, në secilën komunë, numri më i madh i prokurimeve është i fokusuar në kategorinë për punë, respektivisht investime kapitale.

Një shqetësim i identifikuar gjatë këtij monitorimi, është se komunat e Ferizajt nuk kishte planifikuar aktivitetet për

organizimin e përvjetorëve dhe festave, ndërsa komuna e Istogut, nuk kishin paraparë në planifikimin e prokurimit aktivitetet për organizimin e përvjetorëve. Tabela në vijim, pasqyron planifikimin e tre komunave tjera për këto aktivitete:

## VLERA E PLANIFIKUAR



**TABELA 5. PLANIFIKIMI I PROKURIMEVE PËR FESTA PËR KOMUNAT E PRIZRENIT, LIPJANIT DHE PODUJEVËS**

Në vazhdim, hulumtimi kishte identifikuar raste (Komuna e Ferizajt: furnizime me uniforma për zyrtarët komunal dhe furnizim me uniforma për stafin e shëndetësisë; dhe Komuna e Lipjanit: kërkesa për furnizime me inventar dhe disa kërkesa për shërbime të subvencionimit), të cilat kanë mundur të jenë një aktivitet i vetëm, dhe kështu të kursehet në kohë, si dhe të sigurohet një çmim më i mirë i tregut.

Për të analizuar korrektësinë e planifikimeve të prokurimit, është bërë një analizë krahasuese ndërmjet dhjetë tenderëve të parë të shpallur në e-prokurimi për furnizime për secilën nga komunat e përzgjedhura kundrejt planifikimeve të prokurimit. Hulumtimi kishte gjetur se në afër 77% të këtyre prokurimeve, kishte mos përputhje ndërmjet asaj që ishte planifikuar dhe asaj që ishte tenderuar. Te dhënat nga kjo analizë janë paraqitur me poshtë te ndara sipas komunave.

## PRIZREN

Analiza tregon se vlera e tenderëve të shpallur nga Komuna e Prizrenit, në dhjetë tenderët e parë për furnizime, ishte për 78% më e lartë se ajo çfarë ishte planifikuar. Dallimi më i madh është vërejtur tek kërkesa për furnizim me zhavorr, ku komuna kishte planifikuar t'i shpenzonte 250 mijë euro, ndërsa kishte shpallur tender për furnizim në vlerë të 1.5 milion eurove. Gjithashtu shohim se kemi një shpërputhje të vlerave dhe sasive të planifikuara dhe të tenderuar në gjithësejt shtatë nga nëntë planifikimet për prokurim, ndërsa një tender nuk ishte planifikuar. Tenderi për furnizim me material administrativ për nevojat e shëndetësisë primare në vlerë prej 30,000€ nuk ishte planifikuar fare për vitin 2019. Drejtoria e Financave duhet të angazhohet më konkretisht me departamentet përkatëse, për t'u siguruar që nevojat e komunës dhe institucioneve vartëse adresohen në mënyrë sa më të drejtë gjatë fazës së hartimit të buxhetit komunal për vitin në vijim.

**TABELA 6. KRAHASIMI NDËRMJET DHJETË TENDERËVE TË PARË PËR FURNIZIME TË SHPALLURA NGA KOMUNA E PRIZRENIT KUNDREJT PLANIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR TË PROKURIMIT**

| Përshkrimi                                                                                  | Planifikimi 2019 |        |         | Tenderimi 2019   |                              |           |
|---------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|--------|---------|------------------|------------------------------|-----------|
|                                                                                             | Sasia            | Njësia | Vlera   | Sasia            | Njësia                       | Vlera     |
| 1 Furnizimi i fermerëve me foli plastike, perime fushë e hapur dhe agrofoli-s               | 12,000           | Copë   | 30,000  | 32,500           | Copë                         | 30,000    |
| 2 Furnizim me farë misri                                                                    | 1,050            | Copë   | 32,000  | 1,050            | Copë                         | 32,000    |
| 3 Furnizimi me material shpenzues për zyre për nevojat e Komunës së Prizrenit               | 10,000           | Copë   | 20,000  | 152,290          | Copë                         | 15,000    |
| 4 Festat Mjedisore                                                                          | 100              | Copë   | 10,000  | 6,913            | Copë                         | 18,000    |
| 5 Furnizim me pajisje laboratorike për nevojat e shërbimeve shëndetësore në kujdesin primar | 1                | Copë   | 40,433  | 2                | Copë                         | 40,433    |
| 6 Furnizimi me zhavorr për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit                   | 10,000           | M3     | 250,000 | 1                | Nuk ka sasi (çmimi për 1 m3) | 1,500,000 |
| 7 Furnizim me pajisje sinjalizuese dhe instalimi i tyre në Komunën e Prizrenit              | 1                | Copë   | 40,000  | 1                | Copë                         | 450,000   |
| 8 Furnizim me GPS për veturat zyrtare të Komunës të Prizrenit                               | 1                | Copë   | 18,000  | 1                | Copë                         | 9,800     |
| 9 Furnizimi i bletarëve me centrifuga për nxjerrjen e mjaltit në Komunën e Prizrenit        | 120              | Copë   | 48,300  | 120              | Copë                         | 48,300    |
| 10 Furnizim me material administrativ për zyrë për nevojat e shëndetësisë primare           | 0                | 0      | -       | 53,110           | Copë                         | 30,000    |
| <b>VLERA TOTALE</b>                                                                         | <b>488,733</b>   |        |         | <b>2,173,533</b> |                              |           |

## SUHAREKË

Mos përputhje ndërmjet planifikimeve të prokurimit dhe tenderëve të shpallur vërehen edhe në Komunën e Suharekës, edhe pse dallimi ndërmjet tyre prej 10% është dukshëm më i ulët se në komunën e Prizrenit. Po ashtu, tek komuna e Suharekës, vlera e tenderuar është më e vogël se vlera e planifikuar. Ky dallim nuk paraqet një problem sa i përket disponueshmërisë së fondeve apo detyrimeve të reja, megjithatë planifikimi më i lartë i shpenzimeve redukton mundësinë e investimeve shtesë. Vetëm në 10 tenderët e parë për furnizime, dallimi në vlerë është 53,550 Euro, të cilat mund të planifikoheshin në projekte shtesë në komunë. Nga dhjetë tenderët e parë të analizuar, në Komunën e Suharekës nuk ishte planifikuar furnizimi për pajisje për shkollën e mesme teknike. Edhe pse ky tender ishte i vlerës së vogël, kjo thekson nevojën e drejtorisë së arsimit dhe financave të rrisin bashkëpunimin me institucionet arsimore gjatë procesit të planifikimit.

**TABELA 7. KRAHASIMI NDËRMJET DHJETË TENDERËVE TË PARË PËR FURNIZIME TË SHPALLURA NGA KOMUNA E SUHAREKËS KUNDREJT PLANIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR TË PROKURIMIT**

| Përshkrimi                                                                                                         | Planifikimi 2019 |         |              | Tenderimi 2019 |        |              |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|---------|--------------|----------------|--------|--------------|
|                                                                                                                    | Sasia            | Njësia  | Vlera        | Sasia          | Njësia | Vlera        |
| 1 Ngritja e serave - furnizimi dhe montimi i tyre                                                                  | 1                | komplet | 89,000 EURO  | 17             | Copë   | 89,000 EURO  |
| 2 Furnizim me barëra për nevojat e Qkmf-së                                                                         | 1                | komplet | 75,000 EURO  | 87             | Lloje  | 60,000 EURO  |
| 3 Furnizim me koshere për bletari                                                                                  | 1                | komplet | 9,500 EURO   | 279            | Copë   | 9,500 EURO   |
| 4 Furnizimi me E-kioska për shërbime me dokumenta                                                                  | 1                | komplet | 13,500 EURO  | 16             | Copë   | 22,000 EURO  |
| 5 Furnizim me material hidrosanitari, ndriqim, elektrik etj - Administratë, arsim, shëndetsi dhe drejtorite tjera. | 1                | komplet | 66,000 EURO  | 17,205         | Copë   | 120,000 EURO |
| 6 Furnizim me Laptop për asambleist dhe paisje zërimi për sallën e Asamblesë Komunale                              | 1                | komplet | 61,000 EURO  | 58             | Copë   | 14,500 EURO  |
| 7 Furnizimi me paisje për punëtorinë teknike të rrobaqepsisë në SHMT Skender Luarasi -Suharekë                     | 0                | 0       | -            | 9              | Copë   | 4,500 EURO   |
| 8 Furnizim me mjete konkretizimi -paisje me kabinete                                                               | 1                | komplet | 90,000 EURO  | 531            | Copë   | 90,000 EURO  |
| 9 Blerja e paisjeve mjeksore për QKMF, QMF dhe ambulancë-FURNIZIM ME AUTOAMBULANCË                                 | 1                | komplet | 100,000 EURO | 1              | Copë   | 40,000 EURO  |
| 10 Furnizimi, mirembajtja dhe servimi i klimave                                                                    | 1                | komplet | 9,000 EURO   | 149            | Copë   | 9,950 EURO   |
| <b>VLERA TOTALE</b>                                                                                                | <b>513,000</b>   |         |              | <b>459,450</b> |        |              |

## FERIZAJ

Vlera e dhjetë tenderëve të shpallur kundrejt planifikimit të prokurimit për komunën e Ferizajt është vetëm 2% më e lartë (7,451.00€). Megjithatë, edhe kjo komunë sikurse dy komunat e më sipërme, nuk kishte arritur të bëjë një planifikim të mirëfilltë të sa i përket nevojave të shkollave, qendrave sociale dhe Qendrës së Mjekësisë Familjare, që nënkupton se drejtorja e financave duhet të rrisë koordinimin me këto institucione gjatë përpilimit të buxhetit, me qëllim të evitimit të prokurimeve jashtë planifikimeve vjetore. Nga dhjetë tenderët e parë të kësaj komune, edhe pse në vlera të vogla, katër prokurime nuk ishin fare në planifikimin e prokurimit për vitin 2019.

**TABELA 8. KRAHASIMI NDËRMJET DHJETË TENDERËVE TË PARË PËR FURNIZIME TË SHPALLURA NGA KOMUNA E FERIZAJT KUNDREJT PLANIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR TË PROKURIMIT**

| Përshkrimi                                                                                                                                                  | Planifikimi 2019 |        |         | Tenderimi 2019 |         |               |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|--------|---------|----------------|---------|---------------|
|                                                                                                                                                             | Sasia            | Njësia | Vlera   | Sasia          | Njësia  | Vlera në Euro |
| 1 Furnizimi me artikuj për pajisjen e një dhome miqësore në SHFMU "Tefik Çanga" Ferizaj.                                                                    | -                | -      | -       | 1              | komplet | 3,000         |
| 2 Furnizimi i fermerëve me serra dhe sistem të ujitjes pikë-pikë                                                                                            | 1                | set    | 58,000  | 90             | copë    | 66,667        |
| 3 Furnizimi i fermerëve me fidane të arrave dhe sistemin e ujitjesë pikë-pikë                                                                               | 1                | set    | 25,000  | 3,190          | copë    | 25,000        |
| 4 Furnizimi me material gjenetik dhe mbar-simi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave                                                              | 1                | set    | 140,000 | 14,000         | copë    | 140,000       |
| 5 Furnizimi i fermerëve kultivues të grurit me impute bujqësore - pleh artificial azotik                                                                    | 1                | set    | 35,000  | 140,000        | KG      | 35,000        |
| 6 Veshëmbathje për Brigadën Zjarrfikëse                                                                                                                     | -                | -      | -       | 330            | copë    | 6,000         |
| 7 Paisje me pompa të ujit dhe me mjete tjera për Brigadën e Zjarrfikësve                                                                                    | 1                | set    | 15,381  | 61             | copë    | 22,000        |
| 8 Furnizimi me inventar shkollor dhe zyre për nevoja të Administratës Komunale dhe Institucioneve të tjera që funksionojnë në kuadër të Komunës së Ferizajt | 1                | set    | 150,000 | 4,626.3        | copë    | 120,000       |
| 9 Furnizim me ushqim, pije dhe material higjienik për Shtëpinë e Komunitetit - Ferizaj                                                                      | -                | -      | -       | 7,272.00       | copë    | 10,000        |
| 10 Furnizimi dhe vendosja e rrjetit kontrollues për monitorimin e mbarëvajtjes në punë të personelit të QKMF-së                                             | -                | -      | -       | 565            | copë    | 3,165         |
| <b>VLERA TOTALE</b>                                                                                                                                         | <b>423,381</b>   |        |         | <b>430,832</b> |         |               |

## LIPJAN

Dallime ndërmjet dhjetë tenderëve të parë të vitit 2019 dhe planifikimeve janë vërejtur edhe tek komuna e Lipjanit. Tek kjo komunë, vlera e tenderëve është 16% më e lartë se vlera e planifikuar për vitin 2019. Dallimi prej 54,893€ i atribuohet kryesisht planifikimit për furnizim me pajisje për QKMF dhe ndërtimit të serave. Tek furnizimi me pajisje për QKMF, edhe pse tenderi është për dy vite, vlera e parashikuar e tenderit tejkalon vlerën e planifikuar për 142.8%. Meqë planifikimi nuk përmban sasi të parashikuara për blerje, është e pa mundur të analizohen shkaktarët e një rritje të tillë. Tutje, tenderi "Blerja e inventarit në shkollë" ishte planifikuar si blerje e inventarit për nevojat e komunës. Edhe tek komuna e Lipjanit, nga 10 tenderët e parë të shpallur, kemi dy të cilët nuk ishin në planifikimin e prokurimit për këtë vit. Edhe pse në vlera të vogla, të dy këto prokurime do të mund të parashikoheshin sikur planet e investimeve të shqyrtoheshin në mënyrë të detajuar, si dhe të kishte një bashkëpunim më të mirë me institucionin parashkollorë me qëllim të identifikimit të nevojave të tyre.

**TABELA 9. KRAHASIMI NDËRMJET DHJETË TENDERËVE TË PARË PËR FURNIZIME TË SHPALLURA NGA KOMUNA E LIPJANIT KUNDREJT PLANIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR TË PROKURIMIT**

| Përshkrimi                                                                                                                                | Planifikimi 2019 |        |        | Tenderimi 2019 |             |               |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|--------|--------|----------------|-------------|---------------|
|                                                                                                                                           | Sasia            | Njësia | Vlera  | Sasia          | Njësia      | Vlera në Euro |
| 1 Furnizimi me repromaterial bujqësor për ekonominë e shkollave                                                                           | 9000             | KG     | 8,000  | 30             | të ndryshme | 5,000         |
| 2 Blerja e inventarit në shkollë                                                                                                          | 2209             | copë   | 60,000 | 2214           | Copë        | 60,000        |
| 3 Furnizimi me pajisje për QKMF, kontrate dy vjeqare                                                                                      | -                | 0      | 35,000 | 60             | Copë        | 85,000        |
| 4 Furnizimi dhe instalimi i aparaturës për digjitalizimin e QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve                                                    | 550              |        | 35,000 | 2,267          | Copë        | 35,000        |
| 5 Blerja e autoambulances për QKMF dhe automjetit për nevojat e hemodializes                                                              | 1                | copë   | 52,000 | 2              | Copë        | 52,000        |
| 6 Furnizimi me motokultivator për përfituesit e subvencioneve                                                                             | 70               | copë   | 45,000 | 71             | Copë        | 30,000        |
| 7 Furnizimi me arka për bltë                                                                                                              | 45               | copë   | 5,000  | 220            | Copë        | 10,000        |
| 8 Furnizimi dhe montimi i serrave                                                                                                         | 90               | copë   | 45,000 | 133            | Copë        | 60,000        |
| 9 Furnizimi me fidane dekorative drunore për gjimnazin Ulpiana, furnizimi dhe mbjellja e luleve në vazot në sheshin Adem Jahari në Lipjan | -                | -      | -      | 64             | Copë        | 1,870         |
| 10 Furnizimi i qerdhes me pajisje të ndryshme                                                                                             | -                | -      | -      | 57             | Copë        | 1,023         |
| <b>VLERA TOTALE</b>                                                                                                                       | <b>285,000</b>   |        |        | <b>339,893</b> |             |               |

## PODUJEVA

Tek komuna e Podujevës, analiza tregon se nga dhjetë tenderët e parë për furnizime, të shpallura gjatë vitit 2019, kemi mos përputhje të vlerave në shtatë prej tyre, ndërsa tre të tjera nuk ishin planifikuar fare. Vlera e këtyre tenderëve ishte 23% më e lartë se ajo e planifikuar. Ndërsa, për shkak të mos përfshirjes së sasive në planifikimin e prokurimit, është e pamundur të vlerësohet nëse ky dallim i atribuohet rritjes së sasive apo çmimeve për njësi. Njëjtë sikurse te komunat e sipërme, edhe tek komuna e Podujevës, shohim një nevojë të theksuar të koordinimit ndërmjet departamenteve dhe institucioneve vartëse gjatë fazës së hartimit të buxhetit, si dhe planifikimit të prokurimit.

**TABELA 10. KRAHASIMI NDËRMJET DHJETË TENDERËVE TË PARË PËR FURNIZIME TË SHPALLURA NGA KOMUNA E PODUJEVËS KUNDREJT PLANIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR TË PROKURIMIT**

| Përshkrimi                                                                                                                                                                   | Planifikimi 2019 |        |         | Tenderimi 2019 |             |               |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|--------|---------|----------------|-------------|---------------|
|                                                                                                                                                                              | Sasia            | Njësia | Vlera   | Sasia          | Njësia      | Vlera në Euro |
| 1 Furnizim me oksigjen për nevoja të emergjencën në QKMF                                                                                                                     | -                | -      | -       | 240            | copë        | 4,000         |
| 2 Furnizim me Laptop për nevoja të Kuvendit                                                                                                                                  | -                | -      | 51,000  | 22             | copë        | 9,000         |
| 3 Furnizimi dhe montimi me qelq për nevoja të Institucioneve komunale                                                                                                        | -                | -      | 6,200   | 400            | m2          | 8,000         |
| 4 Blerja e makinave për pastrim të dyshemëve për nevoja të shkollave                                                                                                         | -                | -      | 7,000   | 5              | copë        | 15,000        |
| 5 Furnizimi dhe montimi i kamerave në disa shkolla në Podujevë                                                                                                               | -                | -      | 43,100  | 2,238          | të ndryshme | 12,000        |
| 6 Furnizim me motokultivator dhe pajisje përcjellëse                                                                                                                         | -                | -      | 100,000 | 900            | copë        | 148,000       |
| 7 Furnizim me shoqëri bletësh për bletarë                                                                                                                                    | -                | -      | -       | 1,000          | copë        | 80,000        |
| 8 Furnizimi dhe instalimi i panelit optik për printerin carestream 5950                                                                                                      | -                | -      | -       | 2              | copë        | 5,000         |
| 9 Blerja dhe montimi i laurave, sistemit të menaxhimit të radhës si dhe detektuesit të metalit (scanner metal detector) për nevojat e ndërtesës së re të objektit të Komunës | -                | -      | 11,000  | 4              | copë        | 17,500        |
| 10 Furnizimi dhe montimi me pajisje laboratorike për kabinete mësimore për shkollat Naim Frashëri dhe Aleksandër Xhuvani Podujevë                                            | -                | -      | 35,000  | 41             | të ndryshme | 30,000        |
| <b>VLERA TOTALE</b>                                                                                                                                                          | <b>253,300</b>   |        |         | <b>328,500</b> |             |               |

Nga dhjetë tenderët e parë të shpallur nga komuna e Istogut në vitin 2019, nuk kishte asnjë që nuk ishte planifikuar paraprakisht. Vlera e këtyre tenderëve ishte 8% më e ulët se vlera e planifikuar. Sikurse tek rasti i komunës së Suharekës, edhe tek komuna e Istogut për shkak të një planifikimi jo të mirë, vetëm në dhjetë tenderët e parë, ka një vlerë prej 40,000€, të cilat mund të planifikoheshin në projekte shtesë në komunë. Gjithashtu, nga dhjetë tenderët e analizuar, nëntë prej tyre kanë mos përputhje me planifikimin e prokurimit, mirëpo për shkak se komuna nuk kishte planifikuar sasinë e prokurimeve, është e pamundur të analizohet dy dallim ndërmjet këtyre dy proceseve. Madje në rastin e tenderit për furnizim me libra, gjatë analizimit të kërkesave të këtij tenderi ishte vërejtur se edhe thirrja për oferta nuk përmbante sasinë, por vetëm kërkesën për çmime, e cila do të ndikonte sasinë që do të porositej. Për më tutje, dy nga tenderët e analizuar nuk i përkisnin furnizimeve. Edhe pse në planifikim të prokurimit, "mirëmbajtja e rrugëve lokale të rendit të iv-të" ishte planifikuar si shërbim, kjo kërkesë ishte klasifikuar si furnizim në e-Prokurimi. Po ashtu tenderi "Paisja e objektit komunal me lift automatik" në planifikim të prokurimit ishte listuar si punë, ndërsa në e-Prokurimi ishte klasifikuar si furnizim. Drejtoria e Financave duhet të rrisë mbikëqyrjen dhe koordinimin me drejtoritë përkatëse gjatë fazës së hartimit të buxhetit dhe planifikimeve, me qëllim që nevojat e komunës dhe institucioneve vartëse të jenë sa më reale.

**TABELA 11. KRAHASIMI NDËRMJET DHJETË TENDERËVE TË PARË PËR FURNIZIME TË SHPALLURA NGA KOMUNA E PODUJË-VËS KUNDREJT PLANIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR TË PROKURIMIT**

| Përshkrimi                                                                                                                                                                                                                                                         | Planifikimi 2019 |        |         | Tenderimi 2019 |               |               |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|--------|---------|----------------|---------------|---------------|
|                                                                                                                                                                                                                                                                    | Sasia            | Njësia | Vlera   | Tenderi        | Njësia        | Vlera në Euro |
| 1 Blerja dhe furnizimi me gypa te kanalizimit dhe ujësjellësit                                                                                                                                                                                                     | -                | -      | 30,000  | 15,920         | të ndryshme   | 50,000        |
| 2 Mirëmbajtja e rrugëve lokale të rendit të iv-të                                                                                                                                                                                                                  | -                | -      | 45,000  | 12,030         | të ndryshme   | 65,000        |
| 3 Furnizimi me material ndertimor per sanimin e gjendjes nga fatkeqesite natyrore                                                                                                                                                                                  | -                | -      | 41,730  | 22             | të ndryshme   | 81.730        |
| 4 Furnizimi me artikuj ushqimore per nevoja te institucioneve komunale                                                                                                                                                                                             | -                | -      | 57.500  | 173            | të ndryshme   | 65,000        |
| 5 Paisja e objektit komunal me lift automatik                                                                                                                                                                                                                      | -                | -      | 25,000  | 1,134          | të ndryshme   | 25,000        |
| 6 Furnizimi dhe montimi i serave tunel                                                                                                                                                                                                                             | -                | -      | 30,000  | 15             | copë          | 20,000        |
| 7 Furnizimi me artikuj pastrimi dhe higjenike                                                                                                                                                                                                                      | -                | -      | 57,500  | 78             | të ndryshme   | 70,000        |
| 8 Instalimi i kamerave në sh.f. bajram curri -në istog, si dhe instalimi i kamerave në tri kopshte( g.yinë, a.jonë ,dhe p.ardhmërisë                                                                                                                               | -                | -      | 11,000  | 4,581          | të ndryshme   | 11,000        |
| 9 Furnizime mjekesore - filma per rentgen dhe furnizime mjekesore -material per laborator per nevoja te qkmf-se                                                                                                                                                    | -                | -      | 198,000 | 94             | copë          | 60,000        |
| 10 Furnizimi me libra dhe lektyra; furnizimi me libra per bibloteken e qytetit; lektyra shkollore per gjimnazin haxhi zeka -istog; lektyra shkollore per shkollen fillore hysni zajmi ne vrelle,dhe lektyra shkollore per shkollen fillore zymer zeka -ne kaligan. | -                | -      | 7,000   | -              | e pa definuar | 15,000        |
| <b>TOTAL VALUE</b>                                                                                                                                                                                                                                                 | <b>502,730</b>   |        |         | <b>462,730</b> |               |               |



Nga analiza e më sipërme shohim se të gjashtë komunat ballafaqohen me probleme të pothuajse të njëjtës natyrë. Gjatë hartimit të buxhetit, të gjitha departamentet duhet të angazhohen edhe në hulumtim të tregut që buxheti i komunës të jetë sa më mirë i planifikuar. Megjithatë, një

hulumtim i tregut do të duhet të bëhej edhe nga zyrtarët e prokurimit gjatë procesit të planifikimit, sidomos duke analizuar historikun e çmimet të autoriteteve tjera kontraktuese për prokurimet e njëjta të paguara gjatë 12 muajve të fundit.

## 2. Kapacitetet Buxhetore (Planifikimi i Prokurimit kundrejt Buxhetit Komunal 2019)

Analiza tregon se në gjashtë komunat e monitoruara 26% e buxhetit të vitit 2019 planifikohet të shpenzohet përmes prokurimit publik. Tabela në vijim pasqyron vlerën e

prokurimeve të planifikuara kundrejt vlerës së buxhetit komunal për vitin 2019:


| Komuna       | Buxheti Komunal 2019    | Planifikimi i Prokurimit 2019 | Dallimi %  |
|--------------|-------------------------|-------------------------------|------------|
| Prizren      | € 47,594,260.00         | € 13,599,968.00               | 29%        |
| Suharekë     | € 16,260,041.00         | € 5,261,315.00                | 32%        |
| Ferizaj      | € 30,934,846.00         | € 5,090,080.22                | 16%        |
| Lipjan       | € 15,896,971.00         | € 3,509,824.00                | 22%        |
| Podujevë     | € 22,032,619.00         | € 6,111,307.00                | 28%        |
| Istog        | € 10,678,115.00         | € 3,214,230.00                | 30%        |
| <b>Total</b> | <b>€ 143,396,852.00</b> | <b>€ 36,786,724.22</b>        | <b>26%</b> |

**TABELA 12. VLERA E PROKURIMEVE TË PLANIFIKUARA KUNDREJT VLERËS SË BUXHETIT KOMUNAL PËR VITIN 201**

Megjithatë, kjo analizë shpërfaq shqetësime lidhur me numrin e prokurimeve në investime kapitale të trashëguara nga vitet paraprake në komunat e Prizrenit

dhe Ferizajt. Në vazhdim, janë paraqitur dallimet në numra të kontratave të planifikuara për këtë kategori të prokurimeve:





**GRAFIKU 1.** DALLIMI NDËRMJET NUMRIT TË PLANIFIKIMEVE PËR INVESTIME KAPITALE KUNDREJT BUXHETIT PËR INVESTIME KAPITALE 2019

Këto të dhëna na tregojnë se 30% (66) e kontratave të buxhetuara në komunën e Prizrenit, dhe 18% (12) në komunën e Ferizajt, janë të trashëguara nga vitet paraprake. Tabela në vijim pasqyron dallimet në vlerat monetare ndërmjet

buxhetit të aprovuar dhe planifikimet përfundimtare për vitin 2019:

| Kategoria e investimeve kapitale | Buxheti Komunal 2019   | Planifikimi i Prokurimit 2019 | Dallimi #               |
|----------------------------------|------------------------|-------------------------------|-------------------------|
| Prizren                          | € 8,984,659.00         | € 9,616,771.00                | € (632,112.00)          |
| Suharekë                         | € 3,275,770.00         | € 3,547,914.00                | € (272,144.00)          |
| Ferizaj                          | € 5,900,660.00         | € 3,312,643.98                | € 2,588,016.02          |
| Lipjan                           | € 2,279,154.00         | € 2,449,155.00                | € (170,001.00)          |
| Podujevë                         | € 2,178,395.00         | € 4,839,607.00                | € (2,661,212.00)        |
| Istog                            | € 557,730.00           | € 2,100,500.00                | € (1,542,770.00)        |
| <b>Total</b>                     | <b>€ 23,176,368.00</b> | <b>€ 25,866,590.98</b>        | <b>€ (2,690,222.98)</b> |

**TABELA 13.** VLERAT MONETARE NDËRMJET BUXHETIT TË APROVUAR DHE PLANIFIKIMET PËRFUNDIMTARE PËR VITIN 2019 PËR KATEGORINË E INVESTIMEVE KAPITALE

Nga tabelat e më sipërme shohim se, edhe pse kemi rreth 14% projekte të bartura nga viti 2018 (që i atribuohen komunave të Prizrenit dhe Ferizajt), planifikimi i prokurimeve për gjashtë komunat e monitoruara për kategorinë e investimeve kapitale është për afër 2,7 milion Euro më i lartë se buxheti për 2019, respektivisht rreth 30% detyrime që do të barten në vitet vijuese.

Përveç në rastin e komunës së Ferizajt, ku vlera e buxhetit është 44% më e lartë se planifikimi për këtë kategori për të mbuluar projektet e trashëguara, në pesë komunat tjera dallimi ndërmjet buxhetit dhe planifikimit të prokurimit është afërsisht 31% përtej kufijve të buxhetit. Dallimi më i madh ndërmjet buxhetit dhe planifikimit të prokurimit vërehet tek komunat e Podujevës dhe Istogut.

### 3. Vlerësimi i kapacitetit dhe aftësive planifikuese së Zyrrave të Prokurimit

Duke pasur parasysh se një planifikim i mirëfilltë i prokurimit, si dhe një proces i mirë varet edhe nga kapacitetet e autoriteteve kontraktuese, ky hulumtim ka analizuar edhe përbërjen e zyrrave të prokurimit në komunat përkatëse.

Tabela në vijim tregon se një zyrtar i prokurimit në vit parashihet të realizoj rreth 25 aktivitete prokuruese. Ky numër është shumë më i lartë se mesatarja botërore ku rezultojn të jenë rreth 14-19 prokurime në vit për zyrtar të prokurimit<sup>4</sup> në shërbime manuale dhe platformat e vetë ndërtuara.<sup>5</sup>

| Komuna       | # i personelit | Numri i aktiviteteve për 2019 | # i prokurimeve për person |
|--------------|----------------|-------------------------------|----------------------------|
| Prizren      | 4              | 153 <sup>6</sup>              | 38                         |
| Suharekë     | 4              | 104                           | 26                         |
| Ferizaj      | 5              | 81 <sup>7</sup>               | 16                         |
| Lipjan       | 7              | 76                            | 11                         |
| Podujevë     | 3              | 122                           | 41                         |
| Istog        | 4              | 101                           | 25                         |
| <b>Total</b> | <b>26</b>      | <b>637</b>                    | <b>25*</b>                 |

**TABELA 14. NUMRI I PROKURIMEVE TË PLANIFIKUARA PËR 2019 KUNDREJT NUMRIT TË ZYRTARËVE TË PROKURIMIT**

\* Mesatarja e prokurimeve për zyrtar të prokurimit

Ngarkesa e tillë në zyrtarët e prokurimit ndikon që ata të mos kenë kohën e duhur për tu fokusuar në hulumtimin e

tregut dhe administrim të prokurimeve, e që janë komponentë kyç në një prokurim të mirëfilltë.

<sup>4</sup> Raporti i Pasqyrës së Prokurimit 2018, Paramount WorkPlace

<sup>5</sup> Platforma elektronike të ndërtuara nga fillimi për qëllime të shfrytëzimit nga kompania apo institucioni

<sup>6</sup> Shtojcë 66 kontrata të bartura nga 2017-2018

<sup>7</sup> Shtojcë 12 kontrata të bartura nga 2017-2018

## VII. HULUMTIMI I TREGUT

Qëllimi i analizimit të tregut gjatë hartimit të planifikimit të prokurimit është që t'i mundësoj autoriteteve kontraktuese të njohin sektorët përkatës blerës, kapacitetet ofertuese dhe çmimet e tregut. Bazuar në këtë njohuri, planifikimi i prokurimit do të ndërtohej sa më i afërt me kushtet e tregut, dhe do të pasqyronte çmime dhe afate sa më realiste.

Gjatë këtij monitorimi, është vërejtur se në komunat e Suharekës, Ferizajt, Lipjanit, Podujevës dhe Istogut ka ekzistuar një bashkëpunim ndërmjet departamenteve përkatëse me qëllim të njohjes së sektorëve kërkues dhe janë përdorur çmime dhe afate historike për projekte të njëjta apo të ngjashme të komunës respektive. Ndërsa në rastin e komunës së Prizrenit, është identifikuar si mangësi bashkëpunimi ndërmjet departamenteve përkatëse, duke shtuar barrën e përgjegjësisë së planifikimit mbi zyrën e prokurimit.

Megjithatë, në mungesë të instruksioneve dhe kapaciteteve (njerëzore dhe teknike), nuk është zhvilluar një analizë e tregut të jashtëm dhe sa paguajnë institucionet e tjera për të njëjtin shërbim. Mungesa e qasjes së shpejtë në informatat lidhur me projektet e realizuara nga qeveria e nivelit lokal dhe qendror rrit rrezikun e planifikimeve të gabuara sa i përket afateve dhe çmimeve bazuar në ofertën e tregut.

## VIII. MENAXHIMI I RREZIKUT

Qëllimi i vlerësimit të rrezikut gjatë procesit të planifikimit të prokurimit është të identifikojë rreziqet e mundshme për projektet dhe procedurat e prokurimit. Ky hulumtim ka gjetur se legjislacioni dhe udhëzimet ekzistuese nuk trajtojnë çështjen e vlerësimit të rrezikut në fazën e planifikimit.

**Gjatë vitit 2019, prokurimi publik në Kosovë ishte ballafaquar me katër sfida të mëdha:**

1. Vendosija e taksës 100%, ndaj produkteve me prejardhje nga Serbia dhe Bosna dhe Hercegovina respektivisht rritja e çmimit të ofertës<sup>8</sup>;
2. Vonesat në aprovimin e Ligjit për Buxhetin 2019<sup>9</sup>, që ndikon në afatet për fillimin e procedurave, respektivisht shkurtin afatin për realizimin e prokurimeve dhe mund të shkaktoj vonesa në fillimin e punëve në investime kapitale, të cilat mund të pengohen më tutje me pengesa meteorologjike;
3. Mungesa e fuqisë punëtore, sidomos në fushën e ndërtimtarisë, e cila reflekton në vonesa të realizimit të projekteve<sup>10</sup>;
4. Vonesat në dhënien e kontratave të centralizuara.

Megjithatë, gjatë këtij monitorimi nuk është vërejtur se komunat e analizuara kanë bërë një analizë të rreziqeve të mundshme, respektivisht ndikimin e tyre në realizimin e planifikimeve të prokurimit, dhe zhvillimin e planeve alternative.

<sup>8</sup> Taksa 100%: A po e ndihmon apo dëmton ekonominë e Kosovës?, Instituti GAP, Maj 2019

<sup>9</sup> Ligji Nr. 06/L -133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, 14 shkurt 2019

<sup>10</sup> Kosova ka mungesë të fuqisë punëtore profesionale në sektorë të ndryshëm, Kallxo.com, 17 gusht 2019, <https://kallxo.com/lajm/kosova-ka-mungese-te-fuqise-punetore-profesioniste-ne-sektore-te-ndryshem/?fbclid=IwAR0hbDflktXOUOqq9yrQNokOehU-cBN-wBD7xV0VrAq7Fu6ALVrCj8rDOuTw>

# X. KONKLUZIONET

**Analiza e procesit të formulimit dhe aprovimit të planifikimit të prokurimit për vitin 2019 tregon se:**



Gjashtë komunat e monitoruara Prizreni, Suhareka, Ferizaji, Lipjani, Podujeva dhe Istogu, i janë përmbajtur afateve ligjore për hartimin e dokumentit si në nivelin lokal, ashtu edhe në dorëzimin e raportit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit.



Vonesat në aprovimin e Ligjit për buxhetin kishin ndikuar në vonesa lidhur fillimin e procedurave për prokurimet e planifikuara nga gjashtë komunat e monitoruara.



Komunat, në përputhje me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik, kishin publikuar në ueb faqe planifikimet e prokurimit, në mënyrë që këto planifikime të jenë të qasshme për publikun. Komuna e Istogut ishte një shembull i mirë i publikimit të këtij dokumenti në formatin Excel, që është lehtë i qasshëm dhe i punueshëm nga palët e interesuara.



Planifikimet e prokurimeve ishin në harmoni me buxhetet e aprovuara të komunave të monitoruara. Megjithatë, vlera e prokurimeve për tejkallonte vlerat e buxhetuara sipas ligjit të buxhetit për afër 2.7 milion Euro. Tejkallimet më të mëdha buxhetore ishin vërejtur tek komunat e Podujevës dhe Istogut.



Hulumtimi tregon se rreth 14% kontratave për investime kapitale ishin kontrata të trashëguara në komunën e Prizrenit dhe Ferizajt. Një shembull i mirë ishte komuna e Ferizajt, e cila kishte marr parasysh detyrimet e bartura nga vitet paraprake në vlerë prej mbi 2 milion eurosh. Komuna e Prizrenit nuk kishte bërë një përllogaritje të tillë, edhe pse kishte 66 kontrata të trashëguara.



Komunat e Ferizajt dhe Istogut nuk kishin bërë planifikime të prokurimit për përvjetorë gjatë vitit 2019. Komuna e Ferizajt nuk kishte bërë planifikime as për festimin e festave të fund vitit. Si dhe në rastin e Ferizajt dhe Lipjanit, ishin vërejtur ndarje të kërkesave të natyrës së njëjtë.



Gjatë analizimit të dhjetë tenderëve të parë për furnizime, të shpallura nga secila nga komunat e monitoruara (60 tender në tërësi), rreth 77% e vlerave dhe sasive të tenderuar nuk përputhen me ato të planifikuara. Gjithashtu, rreth 18% të tenderëve nuk ishin në planifikimet përfundimtare të komunave.



Në përgjithësi, gjatë monitorimit ishte vërejtur një bashkëpunim i mirë ndërmjet departamenteve komunale, ku zyrat e prokurimit kishin punuar me drejtoritë përkatëse gjatë hartimit të planifikimit të prokurimit, përveç në komunën e Prizrenit, ku nuk ishte dëshmuar një bashkëpunim i tillë.



Analiza shpërfaq shqetësime me alokimin jo proporcional të resurseve njerëzore ndërmjet komunave. Përdërisa në komunën e Prizrenit një zyrtar i prokurimit duhet të zhvilloj rreth 38 aktivitete të prokurimit sipas planifikimit final, në komunën e Lipjanit, ky numër bie në 11 sosh. Mbingarkesa e zyrtarëve të prokurimit pamundëson angazhimin e mirëfilltë në zhvillimin e aktiviteteve, me një theks të veçantë në hulumtimin e tregut dhe administrimin e procedurave. Mesatarja e aktiviteteve për zyrtar të prokurimit është 25 në vit, e që është mbi mesataren botërore të 14 - 19 aktivitete për zyrtar.



Një mangësi është vërejtur tek të gjitha komunat e monitoruara, respektivisht zyrat e prokurimit, me ç' rast asnjëra nga to nuk kishte bërë një analizë të rreziqeve, dhe plan për menaxhimin e tyre.



Komunat e Prizrenit, Lipjanit dhe Istogut kishin dorëzuar në AQP planifikimin e prokurimit para aprovimit të buxhetit nga Kuvendi i Kosovës. Meqë Ligji për Buxhetin kishte efekt financiar nga 1 janar 2019, dhe nuk kishte pësuar ndryshime në nivelin lokal, planifikimet për 2019 nuk ishin rrezikuar..

# XI. REKOMANDIMET

1. Kryetarët e komunave duhet të angazhohen që të harmonizojnë numrin e zyrtarëve të prokurimit krahas volumit të aktiviteteve të prokurimit. Harmonizimi i ngarkesës së punës do të rezultonte në rritjen e kualitetit të prokurimeve publike, duke përfshirë jo vetëm planifikimin por edhe fazat e tjera të prokurimit.
2. Udhëheqësit e zyrës së prokurimit duhet të ngrisin shqetësime lidhur me mospërputhjen ndërmjet vlerave të planifikuara të prokurimeve dhe vlerave të buxhetuara.
3. Kryetari i komunës duhet të sigurohet se informatat relevante (sasitë, njësitë dhe vlerat) për prokurime të furnizimeve janë të përfshira në planifikim të prokurimit, para aprovimit të planifikimit përfundimtar.
4. Drejtoria e Financave në Komunën e Prizrenit duhet të analizoj dhe trajtoj me kujdes detyrimet e bartura nga vitet paraprake, me qëllim të zvogëlimit të tyre dhe mënjanimi të bartjes në vitet vijuese.
5. Drejtoritë e financave të të gjitha komunave duhet të rrisin bashkëpunimin dhe koordinimin me institucioneve vartëse gjatë fazës së hartimit të buxhetit vjetor komunal, që nevojat e këtyre institucioneve të përfshihen në mënyrë sa më të drejtë.
6. Zyra e Prokurimit të komunave të Ferizajt dhe Istogut duhet të parashohin në planifikimet e tyre të prokurimit aktivitetet për shënimin e përvjetorët brenda vitit kalendarik. Gjithashtu, komuna e Ferizajt duhet të planifikoj edhe aktivitetet për festat e fund vitit.
7. Të gjitha zyrat e prokurimit, e veçanërisht ato të Ferizajt dhe Lipjanit, duhet të fokusohen në përmbledhjen e sa më shumë kërkesave të njëjta brenda një aktiviteti të prokurimit.
8. Për të adresuar sfidat e sipër cekura, komunat duhet të fillojnë angazhimin në hartimin e planifikimit të prokurimit qysh në fazën e buxhetimit, kur edhe identifikohet nevoja për blerje. Kjo do të ndihmonte në identifikimin e akterëve të përfshirë si dhe parashikimin sa më të afërt të kushteve të tregut dhe afatet e realizimit të prokurimeve.
9. Komunat duhet të presin deri në miratimin e ligjit për buxhetin para se të dorëzojnë planifikimet e tyre në AQP

# SHTOJCA 1: PASQYRAT INDIVIDUALE TË KOMUNAVE



Komuna e Prizrenit kishte respektuar afatet ligjor për përgatitjen dhe dorëzimin e planifikimit të prokurimit tek Kryetari i Komunës. Zyra e Prokurimit kishte filluar procesin e planifikimit të prokurimit më 01.10.2018, ndërsa data e përfundimit të procesit të planifikimit paraprak të prokurimit ishte data 30.11.2018 me pjesëmarrje të drejtorive përkatëse të nivelit komunal, zyra e prokurimit, zyr-tari kryesor financiar, dhe zyrtari kryesor administrativ.

Pas shqyrtimit të gjitha kërkesave të natyrës së njëjtë, me qëllim të mbledhjes dhe evitimit të procedurave të shum-ta të prokurimeve, janë diskutuar dhe adresuar të gjitha planifikimet për festa dhe përvjetorë, dhe pas kompletimit, plani i prokurimit është dorëzuar tek kryetari i komunës para datës 01 dhjetor 2018. Për shkak të vonesave të pa-parashikuara të miratimit të ligjit për buxhetin nga Kuvendi i Kosovës, përfundimi i planifikimit të prokurimit këtë vit është ballafaquar me vonesa.

Planifikimi përfundimtar i prokurimit ishte dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit me datën 07.02.2019. I njëjti është publikuar në ueb faqen e komunës me datën 28.02.2019.

Në bazë të Planit të Prokurimit në Komunën e Prizrenit për vitin 2019 kemi 153 kontrata të parapara, ku nga 153 kemi 32 ose 21 % kontrata për furnizim në vlerë totale prej 2,009,171.00 euro, 24 ose 16 % kontrata për shërbime në vlerë prej 1,854,026.00 euro, 94 ose 61 % kontrata për punë në vlerë monetare prej 9,616,771.00 euro dhe tre konkurse për projektim, ose 2%, në vlerën 120,000.00 euro.

Në bazë të analizimit të buxhetit për vitin 2019 në Kornizën Afatmesme Buxhetore vërehet se 70% e projekteve për investime kapitale janë përfshirë në planifikimin e prokurim-it publik, duke përfshirë këtu edhe kërkesat e qytetarëve të Prizrenit nga dëgjimet publike si furnizim me makina mjelëse për lopë qumështore, ndriçim i rrugëve publike dhe përkrahja e komunitetit të sportit përmes ndërtimit, mirëmbajtjes dhe renovimit të terreneve sportive. Megjithatë, analiza tregon se 66 projekte kapitale nuk ishin përfshirë në planifikimin e prokurimit.

Komuna e Prizrenit në Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2019 kishte planifikuar 219 projekte kapitale për vitin 2019, vetëm 153 prej tyre janë përfshirë në planifi-kim të prokurimit për vitin 2019, ndërsa 66 projekte janë të trashëguara nga viti paraprak<sup>11</sup>. Shumica e projekteve kanë të bëjnë me investime infrastrukturë rrugore, bujqësi, arsim, shërbime shëndetësore, turizëm, dhe administratë.

Komuna e Prizrenit ka të planifikuara disa kontrata kornize për furnizime, kohëzgjatja e të cilave është 12 deri në 36 muaj. Disa prej tyre janë: furnizim me pajisje sinjalizuese dhe instalimi i tyre në Komunën e Prizrenit, furnizimi me zhavorr për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizren-it, furnizimi me material shpenzues për zyre për nevojat e Komunës së Prizrenit, shërbimet e pastrimit, etj. Gjithashtu, Komuna e Prizrenit kishte planifikuar prokurime për festa gjatë vitit 2019 në vlerë prej 40,000.00 Euro.

<sup>11</sup> Sipas konfirmimit të pranuar nga KK Prizren me 15.07.2019



## Komuna e Suharekës

Komuna e Suharekës kishte respektuar afatin ligjor për përgatitjen dhe dorëzimin e planifikimit të prokurimit tek Kryetari i Komunës. Komuna e Suharekës ka filluar procesin e planifikimit të prokurimit me datën 01.09.2018, ndërsa ky planifikim paraprak i prokurimit ishte me datën 01.11.2018, dhe ishte dorëzuar te Kryetari i Komunës para datën 01.12.2018. Pjesëmarrësit e përfshirë në proces të planifikimit të prokurimit ishin: drejtoritë – njësitë, zyra e prokurimit, zyrtari kryesor financiar, QKMF – si njësi e veçantë, zyrtari kryesor administrativ dhe OJQ-të.

Planifikimi i prokurimit përputhet me projekt buxhetin e aprovuar nga Kuvendi Komunal i Suharekës. Pasi janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e natyrës së njëjtë, me qëllim të mbledhjes dhe evitimit të procedurave të shumta të prokurimeve, punët dhe shërbimet që janë të përbashkëta kryesisht janë paraqitur të përbashkëta, si dhe janë diskutuar dhe adresuar të gjitha planifikimet për festa dhe përvjetorë meqë komuna Suharekës e ka një projekt të veçantë për rregullimin e ambienteve festive dhe për çdo vit hyn në planifikim të prokurimit në kuadër të drejtorisë për kulturë, rini dhe sport.

Planifikimi final është dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit me datën 21.02.2019, për arsye se buxheti i Kosovës është miratuar me vonesë. I njëjti është publikuar në ueb faqen e komunës me datën 21.02.2019.

Në bazë të Planit të Prokurimit në Komunën e Suharekës për vitin 2019 kemi 81 kontrata të parapara, ku nga 81 kemi 18 ose 17 % kontrata për furnizim në vlerë totale

prej 816,600.00 euro, 21 ose 20 % kontrata për shërbime në vlerë prej 896,805.00 euro, 65 ose 63 % kontrata për punë në vlerë monetare prej 3,547,910.00 euro. Komuna e Suharekës nuk kishte planifikuar asnjë prokurim për konkurse për projekte për vitin 2019.

Në bazë të analizimit të buxhetit dhe planit të prokurimit vërehet se të gjitha projektet e buxhetuara ishin përfshirë në planifikim, si dhe ishin marrë për bazë kërkesat e qytetarëve të komunë së Suharekës, të dala nga dëgjimet publike.

Komuna e Suharekës në Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2019 kishte planifikuar 104 projekte në investimet kapitale, të cilat ishin të përfshira edhe në planin e prokurimit për vitin 2019. Shumica e projekteve kapitale do të investohen në ndërtim të infrastrukturës rrugore, arsim, shëndetësi dhe bujqësi.

Vlen të theksohet se komuna e Suharekës kishte arrit të përgatis një plan të mirëfilltë falë koordinimit të njësisë, të cilat tash më e kanë më të qartë përgatitjen e kërkesave drejt zyrës së prokurimit. Si sfidë në hartimin e planifikimit të prokurimit ishin theksuar mungesa e informacionit rreth çmimeve dhe vlerave të tregut. Disa kontrata kornizë janë të planifikuara deri në 12 muaj, dhe hynë në kategorinë e kontratave për furnizim me dru dhe pelet, furnizime mjekësore – barna, mirëmbajtja e automjeteve si dhe shërbimet e pastrimit.



## Komuna e Ferizajt

Komuna e Ferizajt gjatë procesit të hartimit të Planit të Prokurimit për vitin 2019<sup>12</sup> si Autoritet Kontraktues i ka respektuar të gjitha afatet kohore të përcaktuara me legjislacionin aktual për prokurim publik<sup>13</sup>. Pjesëmarrës në këtë proces ishin të gjitha drejtoritë përkatëse, zyra e prokurimit, zyrtari kryesor financiar dhe zyrtari kryesor administrativ.

Planifikimi paraprak i prokurimit nga Drejtoria Komunale e Prokurimit i është dërguar kryetarit të Komunës para datës 1 dhjetor 2018, ndërsa planifikimi i prokurimit përfundimtar është dorëzuar në AQP me datën 15.02.2019. I njëjti është publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës me datën 22 shkurt 2019<sup>14</sup>.

Në bazë të Planit të Prokurimit në Komunën e Ferizajt për vitin 2019 kemi 81 kontrata të parapara, ku nga 81 kemi 27 ose 33.33 % kontrata për furnizim në vlerë totale prej 1,202,678.96 euro, 15 ose 18.52 % kontrata për shërbime në vlerë prej 524,757.28 euro, 38 ose 46.91 % kontrata për punë në vlerë monetare prej 3,312,643.98 euro dhe një konkurs për projektim në vlerën 50,000.00 euro.

Në bazë të analizimit të buxhetit dhe planit të prokurimit vërehet se të gjitha projektet e buxhetuara ishin përfshirë në planifikim, si dhe ishin marrë për bazë kërkesat e qytetarëve të komunë së Ferizajt, të dala nga dëgjimet publike si ndërtimet, rregullimet dhe meremetimet e rrugëve, tro-tuareve dhe kanalizimeve, ndërtimi i kopshtit të fëmijëve në fshatin Samadraxhë, zgjidhja e problemit me ndriçim

publik, funksionalizimi i qendrës së Hendikos, ndërtimi i stallave për bagëti, etj.

Gjatë krahasimit të planifikimeve të prokurimit kundrejt buxhetit të vitit 2019, ishte vërejtur një dallim prej 12 kontratave për investime kapitale. Sipas sqarimit të ofruar nga zyra e prokurimit e Komunës së Ferizajt, 12 kontratat të cilat nuk janë përfshirë në buxhet janë kontrata të bartura nga vitet paraprake, por të cilat do të paguhen në vitin 2019<sup>15</sup>.

Gjatë vitit 2019 Komuna e Ferizajt ka mbi 40 projekte që janë vazhdim të projekteve nga vitet e kaluara, të cilat mbuloohen nga të hyrat vetanake dhe buxheti i konsoliduar i Kosovës, ndërsa 53 projekte janë të reja të planifikuara, ku të gjitha janë të përfshira edhe në planifikimin në Planin e Prokurimit për vitin 2019 në kategorinë e kontratave për punë dhe shërbime.

Gjatë hartimit të Planit, Zyra Komunale e Prokurimit për vitin 2019 nuk ka planifikuar aktivitete të prokurimit për festa dhe përvjetorë. Mos planifikimi i këtyre aktiviteteve rrit mundësitë për prokurime pa plan.

Në kontratat për furnizime Zyra Komunale e Prokurimit ka paraparë dy aktivitete të ngjashme me furnizime me uniforma për zyrtarët komunal dhe furnizim me uniforma për stafin e shëndetësisë, të cilat kanë mundur që të jetë një aktivitet i vetëm, dhe kështu të kursehet në kohë, si dhe të sigurohet një çmim më i mirë.

<sup>12</sup> <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/wp-content/uploads/sites/31/2019/02/Plani-Final-i-Prokurimit-2019.pdf>

<sup>13</sup> [https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/A01\\_Rregullat%20dhe%20Udhezuesi%20Operativ%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/A01_Rregullat%20dhe%20Udhezuesi%20Operativ%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf)

<sup>14</sup> Ueb Faqja e Komunës së Ferizajt, Moduli i Prokurimit: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/category/prokurimi/plani-i-prokurimit/>

<sup>15</sup> E-mail i pranuar nga KK Ferizaj, i datës 31 maj 2019



## Komuna e Lipjanit

MKomuna e Lipjanit gjatë procesit të hartimit të Planit të Prokurimit për vitin 2019 si Autoritet Kontraktues i ka respektuar të gjitha afatet kohore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi<sup>16</sup>. Planifikimi i Prokurimit nga Drejtoria Komunal e Prokurimit i është dërguar kryetarit të Komunës para datës 1 dhjetor 2018 dhe është publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës me datën 15 janar 2019<sup>17</sup>.

Gjatë analizimit të Planit të Prokurimit për vitin 2019 kemi konstatuar se ky plani është në përputhje me planifikimin e buxhetit komunal për vitin 2019, të aprovuar nga Kuvendi komunal i Lipjanit me datën 27 shtator 2018.

Në bazë të Planit të Prokurimit në Komunën e Lipjanit për vitin 2019 kemi 76 kontrata të parapara, ku nga 76 kemi 27 ose 36 % kontrata për furnizim në vlerë totale prej 565,899.00 euro, 21 ose 28 % kontrata për shërbime në vlerë prej 494,770.00 euro, 28 ose 37 % kontrata për punë në vlerë monetare prej 2,449,155 euro. Komuna e Lipjanit nuk kishte planifikuar asnjë prokurim për konkurs projektiv për vitin 2019.

Në bazë të analizimit të buxhetit dhe planit të prokurimit vërehet se të gjitha projektet e buxhetuara ishin përfshirë në planifikim, si dhe ishin marrë për bazë kërkesat e qytetarëve, të dala nga dëgjimet publike.

Në vazhdim, Komuna e Lipjanit kishte planifikuar 17,500.00 euro për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit, si dhe mirënjohje dhe dhurata për festa dhe manifestime tjera.

<sup>16</sup> [https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/A01\\_Rregullat%20dhe%20Udhezuesi%20operativ%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/A01_Rregullat%20dhe%20Udhezuesi%20operativ%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf)

<sup>17</sup> <https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2019/03/RptPlanskiDokument-12.pdf>



## Komuna e Podujevës.

DKomuna e Podujevës gjatë procesit të hartimit të Planit të Prokurimit për vitin 2019 i ka respektuar të gjitha afatet kohore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi<sup>18</sup>. Planifikimi i Prokurimit nga Drejtoria Komunal e Prokurimit i është dërguar kryetarit të Komunës para datës 1 dhjetor 2018 ndërsa është dorëzuar në AQP me datën 28.02.2019. Dokumenti i njëjtë është publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës me datën 26 mars 2019<sup>19</sup>.

Bazuar në të dhënat e monitorimit, planifikimi i prokurimit është i përputhshëm me buxhetin e aprovuar komunal. Për kontratat për furnizim janë planifikuar të realizohen 30 procedura vlere e të cilave kap shifrën 879,620 euro, Kontrata për shërbime janë planifikuar të realizohen 32 procedura vlere e të cilave kap shifrën 635,333 euro ndërkaq për kontrata pune janë planifikuar të realizohen 60 procedura vlere e të cilave kap shifrën 5,326,424 euro. Prej 62 projekte për punë 19 projekte kapitale zgjasin me shumë se 12 muaj.

Në bazë të Planit të Prokurimit në Komunën e Podujevës për vitin 2019 kemi 122 kontrata të parapara, ku nga 122 kemi 30 ose 25 % kontrata për furnizim në vlerë totale prej 774,100.00 euro, 32 ose 26 % kontrata për shërbime në vlerë prej 497,600.00 euro dhe 60 ose 49% kontrata për punë në vlerë monetare prej 4,839,607.00 euro. Komuna e Podujevës nuk kishte planifikuar asnjë prokurim për konkurs projektimi për vitin 2019.

Komuna e Podujevës ka përfshirë 62 projekte për punë në planifikimin e prokurimit nga ku 2 projekte janë paraparë

në kornizën afatmesme buxhetore.

Në vazhdim, Komuna e Podujevës kishte planifikuar 39,200 euro për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit dhe festat mjedisore.

18 [https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/A01\\_Rregullat%20dhe%20Udhezuesi%20Operativ%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/A01_Rregullat%20dhe%20Udhezuesi%20Operativ%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf)

19 Ueb faqja zyrtare e Komunës së Podujevës, moduli i Prokurimit: <https://kk.rks-gov.net/podujeve/category/prokurimi/planet-dhe-raportet-e-prokurimit/>



TKomuna e Istogut zhvillimin dhe aprovimin e planifikimit të prokurimit e ka kryer brenda afatit të caktuar kohorë. Data e fillimit të procesit të planifikimit të prokurimit ka qenë 30.10.2018, kurse data e përfundimit të planifikimit paraprak të prokurimit ka qenë 30.11.2018. Planifikimi paraprak i prokurimit është dorëzuar tek ZKA-ja (Kryetari i Komunës) me datë 30.11.2018. Planifikimi përfundimtar është dorëzuar në AQP me datë 05.02.2019.

Gjatë analizës së shumave dhe aktiviteteve të cilat dalin nga planifikimi i prokurimit dhe buxhetit të komunës së Istogut për vitin 2019 kam arritur në këto përfundime:

Shuma e paraparë e investimeve kapitale (punë) sipas buxhetit për vitin 2019 është 2,861,339 euro, kurse sipas planifikimit të prokurimit kjo shumë është 2.100.500 euro që jep një mospërputhje prej 760,000 eurove.

Shuma e paraparë për shpenzime për mallra dhe shërbime sipas buxhetit për 2019 është 1,345,525 euro.

Në bazë të Planit të Prokurimit në Komunën e Istogut për vitin 2019 kemi 101 kontrata të parapara, ku nga 101 kemi 23 ose 23 % kontrata për furnizim në vlerë totale prej 793,230.00 euro, 15 ose 15 % kontrata për shërbime në vlerë prej 320,500.00 euro dhe 63 ose 62 % kontrata për punë në vlerë monetare prej 2,100,500.00 euro. Komuna e Istogut nuk kishte planifikuar asnjë prokurim për konkurs projektimi për vitin 2019.

Sipas planit të prokurimit për vitin 2019 vetëm nga buxheti komunal janë të parapara investime kapitale në vlerë rreth 2,100,000 euro, por kjo shumë mund të rritet nga participimi i komunitetit për projekte të ndryshme dhe nga të hyrat komunale.

Numri i përgjithshëm i projekteve kapitale të parapara të realizohen sipas planifikimit përfundimtar të prokurimit në vitin 2019 është 63 projekte me shumë totale prej 2,100,500.00 euro. Shumica e projekteve që do të realizohen janë në përputhshmëri me kërkesat e banoreve të cilat ata i kanë shprehur gjatë dëgjimeve buxhetore: asfaltimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, kalbëzimi i trotuareve, ndërtimi i kanalizimeve dhe ujësjellësve dhe betonimi-mirëmbajtja e kanaleve të ujitjes për nevoja në bujqësi.

Në vazhdim, për vitin 2019-2020 janë të parapara 13 kontrata kornizë. Janë disa kontrata kornizë në Agjencinë Qendrore të Prokurimit për tu aprovuar, e nëse kjo dësh-ton atëherë është obligim i AK Istog që për një afat të caktuar kohor të kryej aktivitetet.

Komuna e Istogut nuk kishte bërë planifikime të prokurimeve për shënimin e përvjetorëve por vetëm dekorimin për festat e fundvitit në vlerë prej 5,000.00 Euro.

## SHTOJCA2: Kërkesat ligjore

Planifikimi i prokurimit është një kërkesë ligjore e Ligjit për Prokurim Publik<sup>20</sup>. Sipas këtij ligji, planifikimi i prokurimit duhet të t'i dorëzohet Kryetarit të Komunës jo më vonë se 30 ditë para fillimit të vitit fiskal (që do të thotë jo më vonë se 1 dhjetor të secilit vit). Në këtë proces duhen të identifikohen në detaje vlerat, sasitë, dhe afatet për furnizimet, punët dhe shërbimet, të cilat priten të prokurohen nga Komuna për vitin në vijim. Baza e përpilimit të këtij planifikimi është projekt ligji për buxhetin për vitin vijues, i hartuar nga Komuna. Ky planifikim është një mjet bazë, që u ndihmon zyrtarëve të prokurimit të planifikojnë afatet për shpalljet e tenderëve.

Megjithatë, ligji parasheh edhe një funksion të dytë të këtij planifikimi. Pesëmbëdhjetë ditë pas aprovimit të ligjit për buxhetin nga Kuvendi i Kosovës, Komunitat duhet të përgatisin versionin final të planifikimit të prokurimit, dhe atë ta dërgojnë në Agjencinë Qendrore të Prokurimit. Me këtë rast AQP, do të analizoj produktet e përdorimit të përbashkët për të gjitha autoritetet kontraktuese, të cilat do të inician si prokurime të centralizuara (prokurime të përbashkëta), të realizuara nga po kjo agjenci.

Zhvillimi i planifikimit të prokurimit rregullohet me legjislacionin dytësor për prokurim publik<sup>21</sup>. Sipas kapitullit të pestë të kësaj rregulloreje, planifikimi i prokurimit duhet të përgatitet nga secili autoritet kontraktues. Ky planifikim zhvillohet nga zyra e prokurimit të komunës, me ç'rast zyrtari i përcaktuar në hartimin e këtij dokumenti duhet të përfshij dhe të konsultohet me të gjithë palët kryesore të interesit për të përcaktuar kërkesat, buxhetin

**Njëkohësisht, përveç që planifikimet e prokurimit janë të obliguara që nga prill 2019, ato u ndihmojnë bizneseve të analizojnë se çfarë prokurimesh do të inician komuna gjatë vitit në vijim, dhe të bëjnë përgatitjet e nevojshme për të qenë pjesëmarrës në proces dhe konkurrent në këtë treg.**

në disponueshmëri për secilin prokurim, duke analizuar mënyrën e funksionimit të tregut të ofertës, duke vlerësuar rreziqet dhe përfundimisht duke përcaktuar strategjinë më të mirë të prokurimit për të përmbushur nevojat e komunës.

Një planifikim i mirë i prokurimit, eliminon nevojat për prokurime emergjente, ofron mundësinë e grumbullimit të kërkesave për të siguruar një çmim më të mirë të blerjes, dhe ndihmon për të identifikuar prokurimet afatgjata, të cilat mund të jepen si kontrata kornizë, dhe redukton koston administrative lidhur me tenderime të shpeshta.

Për të zhvilluar këtë planifikim, zyrtarët e prokurimit duhet të përdorin formularin standard të zhvilluar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (Formula-

20 Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 8 Planifikimi i Prokurimit

21 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, fq.10, 10.04.2019, KRPP: [https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Std-Forms&LID=1&PPRCMenu\\_OpenNode=62](https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Std-Forms&LID=1&PPRCMenu_OpenNode=62)

ri B01)<sup>22</sup>. Formulari rregullohet nga dy nene, të cilat adresojnë (1) Identifikimin e Autoritetit Kontraktues (AK), dhe (2) Përshkrimi përmbledhës i kontratave të planifikuara për këtë vit fiskal.

Neni 1 përcakton informatat lidhur me autoritetin kontraktues, si adresa dhe personi kontaktues dhe detajet kontaktuese.

Neni 2 përbëhet nga katër pjesë, definon të dhënat e nevojshme për secilin lloj të kontratave (furnizim, shërbime, punë dhe konkurse të projektimit). Për kontratat për furnizim duhen të plotësohen të dhëna si klasifikimi i produktit, përshkrimi i kontratës, artikulli, njësia matëse, sasia e përafërt vjetore, çmimi i parashikuar për njësi, vlera e parashikuar e kontratës dhe data e parashikuar e fillimit të prokurimit. Ndërsa, për kontratat për shërbime, punë dhe konkurse të projektimit duhet dhënë klasifikimi i produktit, përshkrimi i kontratës, vlera e parashikuar e kontratës dhe data e parashikuar e fillimit të prokurimit. Në rast se Komuna ka paraparë kontrata shumë-vjeçare, atëherë në bashkëpunim me drejtorinë e financave, duhet të ofrohet një "bazë e arsyeshme që aprovimi i buxhetit do të bëhet" për komunën në vitet e ardhshme përkatëse fiskale<sup>23</sup>.

Pas miratimit të buxhetit në kuvend, zyrtari i prokurimit duhet të rishikoj planifikimin e prokurimit të përpiluar paraprakisht, për t'u siguruar që është në përputhje me ligjin për buxhetin. Nëse buxheti i miratuar ka pësuar ndryshime nga projekt propozimi i dërguar nga komuna, zyrtari i prokurimit duhet të pasqyroj ndryshimet në fjalë në planifikim të prokurimit. Planifikimi i prokurimit përfundimtar duhet të dërgohet një AQP, jo më vonë se 15 ditë pas miratimit të buxhetit nga Kuvendi. Menjëherë pas përfundimit të planifikimit të prokurimit, zyrtari i komunës mund të filloj procedurat e koordinimit me njësitë përkatëse për përgatitjen e dokumentacionit të

nevojshëm, për fillimin e procedurave të prokurimit, në bazë të afateve dhe vlerave të parashikuara në buxhet dhe planifikim të prokurimit.

Deri në tre mujorin e parë të vitit 2018 publikimi i planifikimit të prokurimit ishte i ndaluar me legjislacion dytësor. Kjo ndalesë ishte kritikuar ndër vite nga shoqëria civile. Përfundimisht, në prill të vitit 2018, kjo ndalesë ishte larguar nga legjislacioni në fuqi. Me t'u larguar kjo dispozitë, në 2018, 24 komuna<sup>24</sup> publikuan në ueb faqet e tyre planifikimin e prokurimit.

22 [https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=StdForms&LID=1&PPRCMenu\\_OpenNode=62](https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=StdForms&LID=1&PPRCMenu_OpenNode=62)

23 Rregullat dhe Udhezuesi Operativ për Prokurimin Publik, fq.11, 10.04.2019, KRPP: [https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=StdForms&LID=1&PPRCMenu\\_OpenNode=62](https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=StdForms&LID=1&PPRCMenu_OpenNode=62)

24 Indeksi i transparencës në prokurim publik 2018, KDI

# SHTOJCA 3: Formulari i monitorimit të planifikimit të prokurimit



## 2. FORMULARI PËR MONITORIMIN E PLANIFIKIMIT TË PROKURIMIT 2019

1. Data e fillimit të procesit të planifikimit të prokurimit: \_\_\_\_/\_\_\_\_/2018;

2. Data e përfundimit të procesit të planifikimit paraprak të prokurimit: \_\_\_\_/\_\_\_\_/2018;

3. OJQ Monitoruese: \_\_\_\_\_.

4. Emri dhe Mbiemri i monitoruesit: \_\_\_\_\_.

5. Komuna: \_\_\_\_\_.

### PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

1. Pjesëmarrësit e përfshirë në planifikim të prokurimit:

- |          |           |
|----------|-----------|
| 1) _____ | 6) _____  |
| 2) _____ | 7) _____  |
| 3) _____ | 8) _____  |
| 4) _____ | 9) _____  |
| 5) _____ | 10) _____ |

2. A ka përfunduar planifikimi paraprak i prokurimit para datës 02 dhjetor 2018 Po ☐ Jo ☐

Nëse jo, përshkruaj arsyet e vonës: \_\_\_\_\_

3. A është dorëzuar planifikimi paraprak i prokurimit tek Kryetari i Komunës para 01 dhjetor 2018? Po ☐ Jo ☐

4. A përputhet planifikimi i prokurimit me projekt buxhetin e aprovuar nga Kuvendi Komunal? Po ☐ Jo ☐

Komente: \_\_\_\_\_

5. A janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e natyrës së njëjtë me qëllim të mbledhjes dhe evitimit të procedurave të shumta të prokurimeve? Po ☐ Jo ☐

Komente: \_\_\_\_\_

6. A janë diskutuar dhe adresuar të gjitha planifikimet për festa dhe përvjetorë, për të evituar prokurime emergjente apo përjashtime? Po ☐ Jo ☐

Komente: \_\_\_\_\_

7. A është dorëzuar plani i prokurimit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit jo më vonë se 15 janar 2019?

Komente: \_\_\_\_\_



## 2. FORMULARI PËR MONITORIMIN E PLANIFIKIMIT TË PROKURIMIT 2019

8. Sa projekte për punë janë përfshirë në planifikimin e prokurimit? Nr. \_\_\_\_\_  
 Komente: \_\_\_\_\_
9. Sa projekte për punë janë paraparë në Kornizën Afatmesme të Buxhetit? Nr. \_\_\_\_\_  
 Komente: \_\_\_\_\_
10. A ka projekte kapitale, kohëzgjatja e të cilave është me e madhe se 12 muaj? *(analizë me buxhetin komunal për 2019)* Po ☐ Jo ☐  
 Nëse PO, a është përfshirë investimi në Kornizën Afatmesme Buxhetore? *(analizë me KAB për 2019-2021)* Po ☐ Jo ☐  
 Komente: \_\_\_\_\_
11. Komentim i sfidave kryesore gjatë përpilimit të planifikimit të prokurimit?  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_
12. Komente shtesë:  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_



## SHËNIME:

[illegible]

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

352.073.53(496.51-2)"2019"(047)

Metushi Krasniqi, Diana

Procesi i zhvillimit të planifikimit të prokurimit komunal në Kosovë : në komunat e Prizrenit, Suharekës, Ferizajt, Lipjanit, Podujevës dhe Istogut : tetor 2019 / përgatiti Diana Metushi Krasniqi. - Prishtinë : Instituti Demokratik i Kosovës, 2020. – 41 f. : ilustr. ; 21 cm.

**ISBN 978-9951-745-32-1**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

ISBN 978-9951-745-32-1



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

**ID** INSTITUTI  
DEMOKRATIK  
I KOSOVËS